Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e paraqitjes së bonuseve nëpërmjet të besuarit për këtë, ky person i besuar të sjell me vete edhe letërnjoftimin e tij! Sipas politikës ndërkombëtare të biznesit, çdo shpërndarës, që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice, direkt nga zyrat. Gjithashtu, shpërndarës i regjistruar, ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur kopjen e dytë të formularit të regjistrimit së plotësuar më parë dhe dokumentin e porosisë së produktit të plotësuar.

E parregullt:

Asnjëherë mos blini ose shisni produkte në kanale të tjera elektronike apo njësi të shitjes me pakicë. Duke marrë parasysh mundësitë e ndryshme të shitjes nëpërmjet medias elektronike, sipas Forever Living Products: këto konsiderohen si njësi të shitjes me pakicë. Sipas politikës aktuale të biznesit qarkullimi i produkteve, ose publikimi i formularëve të FLP-s në njësitë e shitjes me pakicë është rreptësisht i ndaluar. Qarkullimi i produkteve me anë të medias elektronike mund të bëhet vetëm nëpërmjet faqes së internetit www.flpseeu.com. Lu njoftojmë që dorëzimi i kontratave pa autorizim është i parregullt, pranojmë vetëm kontratat me nënshkrim personal! Çdo nënshkrim tjetër konsiderohet si fallcifikim dokumentash!

Risponsorizim!

Dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen për rregullat e “risponsorizimit” të cilat gjenden në kapitullin e 12-të të Politikës së Biznesit. E rëndësishme është se risponsorizimi s'është proces automatik, por vjen në fuqi vetëm pas plotësimit të formularëve të përcaktuar (deklarata e risponsorizimit, fletë regjistrimi e re) dhe përgjigjes së kushteve. Në lidhje me rregullat e Politikës së Biznesit gabon ai që bashkëpunonjësit distributor të regjistruar njëherë i fut për herë të dytë pa plotësuar procesin e risponsorizimit.



NJOFTIMET E ZYRAVE TË HUNGARISË



- Zyra qendrore e Budapestit: 1067 Budapest, Szondi utca 34., tel: +36-1-269-5370.
Drejtori i marrëdhënjeve ndërkombëtare: Lenkey Péter.
- Magazina e Budapestit: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11., tel: +36-1-291-8995. Drejtori i rajonit: Lenkey Péter.
- Zyra e Debrecenit: 4024 Debrecen, Szent Anna u. 31., tel: +36-52-349-657. Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
- Zyra e Szegedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25., tel: +36-62-425-505. Drejtori i rajonit: Radóczki Tibor
- Zyra e Szekesfehervarit: 8000 Székesfehérvár, Sóstói út 3., tel: +36-22-333-167. Drejtori i rajonit: Földi Attila

Njoftojmë Shpërndarësit tanë të nderuar se vendi i organizimit të Success Day Forever të 23 qershorit 2007, që fillon në orën 10, është: Arena Sportive Papp Laszlo, 1143, Budapest, Stefánia út 2. I mirëpresim të gjithë! Dëshiroj t'ju njoftoj edhe se në këtë ditë asnjë nga magazinat tona s'është hapur.

Produktet e Forever Living Products dalin në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë. I lutemi Distributorëve të nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre, si dhe kopjen e dokumentit të paraqitjes së Zyrës së Taksave dhe Tatimeve të ndërmarrjeve. Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e ndërmarrjes së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë dokumentet e duhura të plotësuara, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i ndërmarrjes. Njoftimi, që ka të bëjë me këtë, është i nxjerrë në zyrat tona, por kolegët tanë mund t'ju njoftojnë edhe me fjalë në këtë aspekt. Numrat aktual dhe të mëparshëm të revistës mujore mund të lexohen në faqen tonë të internetit duke përdorur passwordin „forever”.

Njoftim rreth mundësisë së blerjes me ulje
Për të përdorur mundësinë e blerjes me ulje ju lutemi zbatoni rregullat e mëposhtme:

1. *Deklarata:* Ju lutemi që me vëmendje plotësoni saktësisht çdo pjesë të deklaratës. Nëse e dërgoni personalisht kolegët tanë i kontrollojnë të dhënat, por nëse e dërgoni me postë kjo gjë nuk është e mundur, prandaj ju lutemi që me një vëmendje të madhe kontrolloni të dhënat tuaja, sepse në rast gabimi sistemi i uljes së çmimeve nuk hyn në fuqi.

2. *Blerja:* Gjatë blerjes sistemi i ofron shumën maksimale të uljes atyre që e plotësojnë deklaratën. Blerja do të thotë përdorimin e uljes së çmimeve ose pagesën e bonusave, kështu edhe blerja personale kërkon letërnjoftim me fotografi. Në rastin e blerjes si grup duhet të sillni autorizim të nënshkruar nga dy dëshmitarë të rregullt nga çdo person, për çdo porosi. Kolegët tanë i pranojnë porositë vetëm pasi i kanë kontrolluar këto gjëra. Në rastin e personave me deklaratë mungesa e letërnjoftimit apo e autorizimit sjell refuzimin e porosisë!

3. *Informimi:* Kolegët tanë nëpër magazina vetëm pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi dhe dorëzimit të autorizimeve japin informacione rreth shumës aktuale të uljes.

Bashkëpunonjësit me deklaratë dhe që i marrin bonusat e tyre në formë kuponash, mund të informohen rreth shumave të sakta në adresën Budapest, Szondi u. 34.

Dëshiroj t'ju thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Distributorit tanë të nderuar i marrin porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – me përputhje kohe – në çdo pikë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anullojmë dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakaja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

Porositë tuaja mund t'i bëni në mënyrën e mëposhtme:

- në telefon, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit. Numrat e telefonit: 061-297-5538, 061-297-5539, cel: 0620/456-8141, 0620/456-8149
- nëpërmjet internetit në adresën www.flpshop.hu,
- me sms në numrin e telefonit 0620-478-4732.

Çmimet e transportit:

Budapest	Provincë	
0-5 kg	640 Ft	1260 Ft
5-10 kg	1240 Ft	1720 Ft
10-30 kg	1520 Ft	1940 Ft
Mbi 30 kg	30 Ft/kg	30 Ft/kg



- Çmimet e mësipërme janë të vlefshme deri në 3 porosi/adresë, mbi 3 porosi llogarisim +200 Ft/porosi.
- Çmimi i postimit është 360 Ft/adresë.
- Siguracioni: deri në shumën 200 000 Ft e përmban çmimi i transportit, mbi këtë shumë për çdo 10 000 Ft është 50 Ft.
- Çmimet e mësipërme nuk përmbajnë TVSH-në prej 20%.
- Transportimi i porosive bëhet pas përputhjes paraprake në telefon. Shpenzimet e përputhjes në telefon përmbahen nga çmimet e mësipërme.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Hungarisë:

- Dr. Gabriella Kassai: +36-30-307-7426
- Dr. György Bakanek: +36-20-944-1442
- Dr. Laszlo Kerekes: +36-20-944-1442
- Dr. László Mezôsi, veteriner: +36-20-552-6792



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBISË

- Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127.
- Zyra e Nisit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.
- Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Rade Končara 80. tel.: +381-24-792-195. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.
- Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309-6382. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12:00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.
- Shpenzimet e postës paguhën sipas kursit të PTT Serbisë të ditës

Të nderuar bashkëpunonjës!

U njoftojmë me kënaqësi se edhe sivjet shfaqim programin dobësues "Clean 9 dhe Lifestile 30". Gjatë periudhës së programit mund të paraqiteni dy herë në zyrat tonë për matjen e peshës, dhe në raport me uljen në përqindje të peshës dalin fituesit e çdo kategorie.

Programi "Clean 9 dhe Lifestile 30" zgjat nga 1 prilli deri më 30 qershor. Shkoni të mateni në zyrat tona. Të çlirohemi nga kilet e tepërta me paketën e produkteve Clean 9 dhe Lifestile 30! Qëllimi është peshë më e shëndetshme dhe shpërblimet me vlerë!

- që ndodh shërbimi, por FLP-ja e Beogradit i paguan vetëm nëse porosia e bërë në një numër kodi e kalon 1 pikë krediti.
- Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit.
- Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosisni vetëm personalisht në zyrën tonë.
- Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Serbisë:

- Dr. Biserka Lazarević dhe Dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318



NJOFTIMET E ZYRËS SË MALIT TË ZI

- 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića br: 20. tel: +381-081-245-402, tel/fax: +381-081-245-412. Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakic

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

- Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127



NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS



Zyra e Bijelinës

- Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg Đenerala Draže Mihajlovića br. 3., tel: +387-55-211-784, +387-55-212-605, fax: +387-55-221-780. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.
- Zyra e Banja Lukas: 78 000 Banja Luka, Duško Koščica u. 22., tel.: +387-51-228-280, fax: +387-51-228-288. Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksic. Orari i hapjes: në ditët e punës 9.00-16.30
- Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akifa Seremeta do. 10., tel.: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651.. Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00-16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit organizojmë një Ditë Suksesi Mini në zyrën e FLP-s. Drejtori i rajonit: Enra Hadžović Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387-55-211-784.

Njoftim i zyrës së FLP-s së Sarajevës

- Nga shtatori në shërbimin tonë është këshilltarja dhe specialistja mjekje nga Bosnia-Hercegovina Dr. Esmā Nisic, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja dhe specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:30.
– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhen nga distributori.



NJOFTIMET E ZYRAVE TË KROACISË

- Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Grada Mainza 21., tel.: +385-1-390-9770., fax: +385-1-3909-771. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Zyra e Splitit: 21000 Split. Križine 19. tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

- Porosia telefonike bëhet në numrin +385-1-3909-773. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë, shpenzimet e transportit i paguan FLP-ja.
- Leksionet rreth marketingut dhe produkteve fillojnë çdo të hënë dhe të enjte në orën 18.00 në zyrën qendrore.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510
Dr. Eugenija Sojat Marendic: +385-915107070



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLOVENISË

- 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava. tel: +386-2-575-1270. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Njoftojmë konsumatorët dhe distributorët tanë të nderuar që adresa e zyrës së Sarajevës është: AKIFA ŠEREMETA DO BR. 10, 71000 SARAJEVO, TELEFON: +387-33-760-650 ose 470-682, FAX: +387-33-760-651. Orari i hapjes: 9:00 – 16:30, të mërkurën: 12:00 – 20:00. Në të njëjtin orar bëhen edhe porositë në rrugë telefonike: Numri i telefonit: +387-33-760-650 në Sarajevë, dhe +387-55-211-784 në Bijelinë.

Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

lu njoftojmë se nga shtatori mund të kontaktoni në rrugë telefonike me këshilltaren tonë mjekje specialiste, Dr. Esmā Nisic. Çdo ditë në orarin 18:00 – 21:00 i pret thirrjet tuaja në numrin e telefonit: +387-62-367-545. Këshilltarja jonë mjekje çdo të mërkurë në orarin 17:00 – 19:30 jep konsultim në zyrën e FLP-s të Sarajevës.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788
Dr. Canzek Olga: +386-41824163



NJOFTIMET E ZYRËS SË KOSOVËS

- Prishtinë, Rr. Zagrebi PN, tel.: +381-38-240-781. Drejtori i rajonit: Lulzim Tytynxhii

www.flpseeu.com FLP TV në internet

PROGRAMI nga 07 maj deri në 23 qershor 2007

10.00	Hapja e studios Sonya	15.25	Success Day – Kualifikime – Klubi i Sundimtarëve,	22.00	Hapja e studios Sonya	03.25	Success Day – Kualifikime – Klubi i Sundimtarëve,
10.02	Nature's 18 – Film prezantues produktesh		Managerët, niveli 1 i Profit Sharing	22.02	Nature's 18 – Film prezantues produktesh		Managerët, niveli 1 i Profit Sharing
10.05	Nga bima deri tek produkti	16.40	Success Day – Kualifikime	22.05	Nga bima deri tek produkti	04.40	Success Day – Kualifikime
10.20	FLP-ja prej 25 vitesh		– Niveli 2 dhe 3 i Profit Sharing	22.20	FLP-ja prej 25 vitesh		– Niveli 2 dhe 3 i Profit Sharing
10.35	Success Day – Stevan Lomjanski – Përse FLP-ja?	16.45	Intervistë me Marika dhe Zsolt Rozsahegyi-n – Zsuzsa Lenkey	22.35	Success Day – Stevan Lomjanski – Përse FLP-ja?	04.45	Intervistë me Marika dhe Zsolt Rozsahegyi-n – Zsuzsa Lenkey
10.45	Koncerti i Katalin Pitti-t dhe Sandor Sasvari-t	17.10	Koncerti i György Korda-s dhe Klari Balazs-it	22.45	Koncerti i Katalin Pitti-t dhe Sandor Sasvari-t	05.10	Koncerti i György Korda-s dhe Klari Balazs-it
11.05	Active Probiotic – Film prezantues produktesh	17.35	Përmbledhje e Holiday Rally-t – Porec	23.05	Active Probiotic – Film prezantues produktesh	05.35	Përmbledhje e Holiday Rally-t – Porec
11.10	Dr. prof. Jozsef Pucok – Roli i plotësuesve ushqimor në mënyrën natyrore të jetesës 1.	18.35	Dr. Renata Steiner – Për këtë ia vlen	23.10	Dr. prof. Jozsef Pucok – Roli i plotësuesve ushqimor në mënyrën natyrore të jetesës 1.	06.35	Dr. Renata Steiner – Për këtë ia vlen
11.35	Plani Marketing i FLP-s	18.50	Dr. György Bakanek – Jetesë e shëndetshme në sport	23.35	Plani Marketing i FLP-s	06.50	Dr. György Bakanek – Jetesë e shëndetshme në sport
11.55	Dr. prof. Jozsef Pucok – Roli i plotësuesve ushqimor në mënyrën natyrore të jetesës 2.	19.10	Richard Neihardt – Network marketing dhe komunikim	23.55	Dr. prof. Jozsef Pucok – Roli i plotësuesve ushqimor në mënyrën natyrore të jetesës 2.	07.10	Richard Neihardt – Network marketing dhe komunikim
12.10	Rolf Kipp – Histori suksesi	20.15	Zsuzsanna Uzoni – Nga Supervisor deri tek Senior Manageri	00.10	Rolf Kipp – Histori suksesi	08.15	Zsuzsanna Uzoni – Nga Supervisor deri tek Senior Manageri
12.35	Pro6 – Film prezantues produktesh	20.30	Dariusz Heinbach – Zgjedhje fushe	00.35	Pro6 – Film prezantues produktesh	08.30	Dariusz Heinbach – Zgjedhje fushe
12.40	Dr. Schmitz Anna – Ujë mineral Forever	20.50	Street Dancers, Twister, Honey dhe Kis Bestiak	00.40	Dr. Schmitz Anna – Ujë mineral Forever	08.50	Street Dancers, Twister, Honey dhe Kis Bestiak
13.00	Intervistë me Jozsef Szabo-n – Kata Fekete	21.15	Sandor Toth dhe Edina Vanya – Je përpara	01.00	Intervistë me Jozsef Szabo-n – Kata Fekete	09.15	Sandor Toth dhe Edina Vanya – Je përpara
14.15	Koncerti i Kriszta Kovacs-it		– Rreth çështjeve të rëndësishme shkurt	02.15	Koncerti i Kriszta Kovacs-it		– Rreth çështjeve të rëndësishme shkurt
14.30	Dr. Ilona Juronics – Të shëndetshëm edhe në verë	21.50	Active HA – Film prezantues produktesh	02.30	Dr. Ilona Juronics – Të shëndetshëm edhe në verë	09.50	Active HA – Film prezantues produktesh
14.50	Tibor Viragh – Kjo varet			2.50	Tibor Viragh – Kjo varet		



DUŠAN PAVLOVIĆ

lektor i pavarur

Shumica e njerëzve janë të prirur të qëndrojnë gjatë gjithë jetës brenda zonës së komfortit. Të mendojnë dhe të veprojnë si më parë. Shumë njerëz nuk e kanë të qartë që ky qëndrim sjell rrënjësimin e zakoneve tona, qëndrimin në këtë gjendje të rrënjësuar, e cila në të ardhmen sjell një rënie të pashmangshme. Pra dhurata më e madhe që mund t'ju japim si drejtues bashkëpunonjësve tanë s'është gjë tjetër veçse nxitja për të qenë të hapur ndaj gjërave të reja. Të jemi të gatshëm të marim përsipër sfidat, të planifikojmë me guxim dhe të ndihmojmë edhe të tjerët që të arrijnë qëllimet e tyre.

Veprimi është

Është e rëndësishme të përgatitemi që kushti i arritjes së qëllimeve tona është ndryshimi dhe mësimi, pasi pa ndryshimin e qëndimit dhe veprimeve tona nuk mund të presim ndryshimin e rrethanave tona. Nëse presim përmirësimin e rrethanave pa bërë ndryshim, rezultati do të jetë vetëm zhgënjimi.

Koncepti „veprimi është mësimi me i mirë” përpiket të harmonizojë pikërisht mësimin me ngarkesën emocionale në qëllim të arritjes së qëllimeve të larta dhe të një cilësie më të mirë jete. Natyrisht grupe të ndryshme kulturore duke bërë disa modifikime mund ta zbatojnë sipas parimeve të tyre. Ky koncept përputhet plotësisht me pikëpamjen e presidentit-drejtorit të përgjithshëm të FLP-s, Rex Maughan. Sukseset personale janë të rëndësishme në jetën e gjithë kompanisë, prandaj urojmë që çdo anëtar i familjes së madhe FLP t'i zbatoj me sukses parimet e këtij koncepti.

Qëllimi i përbashkët

Për çdo distributor të ri të FLP-s është e rëndësishme të ketë një qëllim të qartë dhe të përcaktuar mirë. Motivimi i personit është i

domosdoshëm, edhe sponsori i tij i kushton me të drejtë vëmendje. Por përveç motivimit të brendshëm të mos harrojmë që njeriu është edhe krijesë sociale. Na pëlqen të punojmë së bashku dhe të realizojmë qëllime të përbashkëta. Ky element social, nëse përcaktohet mirë, përbën një motivim të mëtijshëm në veprimtarinë tonë të përbashkët. Është e diçka e favorshme po të arrijmë të ekuilibrojmë interesat e personit dhe të komunitetit. Është e rëndësishme që edhe qëllimi i përbashkët të jetë i përcaktuar mirë, pasi kështu mbetet në qendër të vëmendjes gjatë çdo veprimtarie të përbashkët. Ky do të jetë frymëzimi, i cili në periudha të vështira, kur sulmohemi nga faktorë të jashtëm, do të na japë forca. Si duket gjithë kjo në praktikë?

Përsëmbull në çdo vend për muaj mund të marrim pjesë në aktivitetet Success Day. Numri i pjesëmarrësve është një tregues i mirë i funksionimit të biznesit në rajonin e caktuar. Nëse ky numër me kalimin e kohës rritet, mund të jemi të sigurt se biznesi po ecën në rrugën e duhur. Por, a pritët rritja? Përgjigje kësaj pyetjeje i jep ndotja e mjedisit dhe ushimimi jo i duhur. Për Aloe Vera dhe plotësues ushqimor kanë



ë mësuësi më i mirë

nevojë të gjithë. Por e dimë se këto përdoren vetëm nga një pjesë e vogël e njerëzve. Madje shumë njerëz e kërkojnë rrugëzgjdhjen e sigurt për përmirësimin e gjendjes së tyre materiale duke kërkuar mundësinë e duhur. Pra, kemi shumë për të bërë!

Qëllimi i madh i përbashkët krijohet nga shumë qëllime të vogla personale. Cilat janë sukseset personale që kontribuojnë tek e gjitha? Ndërthurja bëhet tepër e qartë kur për realizimin e qëllimit të përbashkët kontribuesit i dallojnë edhe në jetën e tyre ndryshimet: të mirat materiale, sociale, marrdhëniet njerëzore,... Disa drejtues janë të aftë t'i vënë vetes qëllime edhe më të mëdha. Por përcaktimi i qëllimeve nuk është i mjaftueshëm. Këto qëllime duhet t'i kemi parasysh vazhdimisht. Duhet t'i shikojmë dhe t'i ndiejmë. Një fotografi apo një poster të një salle leksioni e cila është plot me skuadrën tonë, dhe pranë saj fotografitë që tregojnë ndryshimet e jetës sonë personale. Të kemi parasysh qëllimin e madh të përbashkët, si dhe forcat motivuese personale!

Mësimi

Përcaktimi i qëllimeve dhe i forcave motivuese është tepër i rëndësishëm, por në vetvete s'është i mjaftueshëm. Nevojitet edhe talent, aftësi, qëndimi i duhur, si dhe njohuria e saktë e detyrave. Në çdo fushë të jetës mund të takohemi me njerëz të cilët janë shumë të talentuar, por është mirë të dimë që edhe ata që janë më pak të talentuar, por tepër të motivuar dhe të gatshëm për të mësuar mund të bëhen të suksesshëm. Thelbi i konceptit nuk fshihet tek shfrytëzimi i aftësive të jashtëzakonshme, por tek përcjellja e njohurive. Në mënyrë që rezultati të jetë më i sigurt, është mirë t'i kushtojmë vëmendje të veçantë tre fushave të mëposhtme, dhe t'i shtojmë njohuritë tona në to:

- metodat
- parimet bazë
- vetënjohja

Duke zhvilluar këto tre fusha bëhemi më të sigurt, më të besueshëm dhe më bindës. Këto aftësi duke funksionuar në mënyrë sinergjiste

me njëra-tjetrën na bëjnë tepër rezultativ.

Metodat

Çdo punë përbëhet nga një radhë veprimtarisht të caktuara të cilat sjellin rezultate. Këto janë metodat, të cilat u përcaktuan gjatë analizimit të fazave të punës, dhe me zbatimin e të cilave në një fushë të caktuar puna të bëhet më efektive. Know-how, pra mënyra se si e punës, bazohet në njohuritë explicit dhe tacit. Njohuritë explicit kanë të bëjnë me mekanizmin e punës. Këto janë njohuri të përcaktuara saktë që mund të ndahen në hapa dhe detyra. Njohuritë tacit mund të përcaktohen më me vështirësi. Këto janë përvojat dhe eksperiencat e siguruar gjatë përdorimit të metodave. Njohuritë explicit janë llogjike dhe të shpjegueshme, kurse njohuritë tacit gjenden më shumë në botën tonë emocionale, krijohen nga intuita jonë, nuk janë aq të vetëdijshme, por veprojnë tek ne dhe puna jonë më tepër në formën e ndjenjave të pavetëdijshme.



Në mënyrë që të jemi në gjendje t'i zbatojmë njohuritë tona është e rëndësishme që të zhvillohemi në mënyrën explicit dhe tacit gjithashtu. Për këtë mund të përdorim metoda të ndryshme:

- mësim, kurse përgatitore, lexim
- përvetësimi i rutinës praktike të punës personale dhe në skuadër gjatë trainimeve
- mbështetje emocionale, reagime të vazhdueshme

Pra nevojitet zhvillimi i dy fushave:

- metodat e punës, teknologjia e network marketingut të FLP-s.
- sistemimi i njohurive dhe përcjellja e metodave të punës

Si mund të zhvillohen këto fusha?

Zotërojmë libra dhe shkrime të shumta me temën e network marketing. Përmbajtja dhe cilësia e këtyre është e ndryshme, por edhe librat më të mirë përkufizojnë vetëm çështje të përgjithshme. Por metodika rrjetndërtuese e FLP-s është e veçantë. Madje e vetme. Kjo duhet mbajtur me çdo kusht përpara

syve gjatë edukimit të metodikës.

Pra, thelbi është:

- metodika teorike e ndërtimit të rrjetit
- përvojat personale të siguruar gjatë praktikës

Përvojat në praktikë të ndërtuesve të rrjetit që kanë arritur suksese dhe drejtimi i kompanisë së bashku ofrojnë një udhëzim dhe një paketë informacionesh e cila përmban parimet bazë që të çojnë me siguri drejt suksesit.

Parimet bazë të ekonomisë moderne

Në vitet e mëparshme forca e punës në shumicën e rasteve ishte pasive dhe e pamotivuar. Nismëria dhe marrja përsipër e përgjegjësisë nuk ishte karakteristike, pra edhe procesi i tregëtisë ishte i njëanshëm dhe i manipulueshëm. Shumica e njeëzve si rezultat i prapagandave të ndryshme ishin të gatshëm të blinin gjëra për të cilat nuk kishin nevojë. Madje kishte sisteme, ku pushteti siguronte dhe

kontrollonte edukimin, forcën e punës, shëndetësinë, pensionet, çështjen e shtëpive,... Pra personi nuk ishte në gjendje që ta planifikonte vetë jetën dhe të kujdesej për të ardhmen e tij.

Ekonomia moderne bazohet në parime plotësisht të ndryshme. Sistemi i krijuar gjatë ndryshimit të paradigmës nuk është as kapitalist, dhe as socialist. Bazohet në dituri, përgjegjësi, nismëri personale dhe elementi bazë i tij është ekulibri i mjedisit social dhe natyror të njeriut. Në jetën e ekonomisë moderne tragëtia nuk është manipulim, por shërbimi i kërkesave të blerësve dhe kujdesi për ta.

Në ditët tona jetojmë periudhën kalimtare. Në jetën dhe punën tonë përzihen efektet e vjetra dhe të reja. Zakonet e vjetra veprojnë akoma me forca të konsiderueshme tek secili prej nesh, kurse vlerat e reja nuk janë akoma të qarta për shumë prej nesh. Kjo shkakton turbullirë në mendjen e shumë njerëzve, dhe kjo turbullirë natyrisht nuk e mbështet zhvillimin e personit.

Sistemi marketing i FLP-s bazohet në parimet e reja. Sistemi siguron rezultate të shkëlqyera nëse qëndrimi dhe puna organizohet dhe realizohet sipas këtyre parimeve bazë. Pra është e rëndësishme që për çdo punonjës të jetë i qartë thelbi, pasi kështu mund të shmangen disfatat e mundshme që vijnë si pasojë e keqkuptimeve të periudhës kalimtare. Është i domosdoshëm përvetësimi i pikëpamjes së re, pasi kjo na e jep aftësinë me të cilën mund të punojmë në mënyrë efektive.

Vetënjohja

Për arritjen e rezultatit optimal është e nevojshme që çdo punonjës t'i përvetësojë metodat e Network Marketingut të FLP-s dhe parimet bazë të ekonomisë moderne – njëkohësisht! Kjo gjë kërkon një njeri të plotë. Më parë për realizimin e punës mjaftonin vetëm duart e forcës së punës, ata nuk pagueshin që të mendonin, por duhet të bënin vetëm atë që u kishin caktuar. Sot situata është ndryshe. Nuk na

mjaftojnë vetëm duart, që të kemi rezultat duhet të veprojmë me zemër dhe me shpirt.

Është e vërtetë që ata që u rritën në sistemin e vjetër sot e ndjejnë me shkak veten të dobët dhe pambrojtur. Shumë prej tyre nuk janë në gjendje ta shikojnë punën si më parë. Duke e njohur më thellë vetveten shumë gjëra bëhen të vetëdijshme, madje disa gjëra mund edhe të ndryshohen. Ekzistenca jonë shfaqet në katër dimensione: fizike, racionale, emocionale dhe spirituale. Tërësia e këtyre na bëjnë kompetent dhe të kënaqur gjatë punës sonë. Pika kryesore e vetënjohjes është të gjejmë misionin tonë personal, si dhe të funksionojmë me harmoni fushat e ndryshme të jetës sonë, rolin tonë në familje, profesion dhe shoqëri. Që t'i bëjmë vend vetes në çdo rol, ndërkohë që punojmë me rezultat në misionin tonë personal, është e nevojshme të zotërojmë vetënjohje. Kjo na çon drejt realizimit të jetës së lumtur, plot me qëllime dhe kuptim, të cilën e meritojmë të gjithë.



DR. EDIT REVESZ
SIKLOSNE
soaring manager



Jemi në pranverë, po vjen vera, dhe të gjithë dëshirojnë të jenë pak më të bukur dhe simpatik! Dëshirojmë t'iu ndihmojmë që programi dietor të mos jetë një përpjekje tjetër e pasuksesshme, por një ekperiencë e shëndetshme, e qëndrueshme, e suksesshme dhe që sjell ndryshim në mënyrën e jetesës!

Si çdo dietë, edhe këtu lindin tre pyetje bazë:

- është e sigurt?
- është e shëndetshme?
- nuk do shëndoshem prapë?

Rënia e shëndetshme dhe e qëndrueshme nga pesha nuk mund të arrihet me një dietë "në formë kure". Që të arrijmë një rezultat të qëndrueshëm kemi nevojë për një ndryshim të vërtetë të mënyrës së jetesës, **elementët bazë** të së cilës janë:

1. krijimi i një diete që i përshtatet personit
2. konsumimi i **plotësuesve ushqimor**
3. ushtrimi i **gjimnastikës**

T'i shikojmë një nga një këto pika!

1. krijimi i një diete që i përshtatet personit


Lëndët ushqimore me cilësinë e duhur i sigurojnë energjinë organizmit tonë, janë të domosdoshme për funksionet jetike dhe funksionimin efektiv të sistemit tonë mbrojtës.

Çdo ditë duhet të konsumojmë yndyra, proteina, karbohidrate, vitamina, lëndë

minerale dhe mikroelementë, por ka rëndësi raporti, cilësia dhe forma e ushqimeve në të cilat i përdorim këto. Është e rëndësishme marrja e lëndëve ushqyese të cilat nuk mundemi ose mund t'i rezervojmë vetëm për një kohë të shkurtër. Të tilla janë proteinat, uji, vitaminat e tretshme në ujë.

Yndyrat kryejnë funksione të rëndësishme fiziologjike në organizëm. Janë burimi i energjisë së krijimit të glukozit, dhe pjesë përbërëse të membranës së qelizës dhe të nervave. Vajosin lëkurën, mbrojnë nga tharja, rrethojnë dhe mbështjellin organet, mbrojnë nga ngrirja. Janë transportuesit e vitaminave të tretshme në yndyra, dhe janë të domosdoshme edhe në krijimin e acideve të tëmthit dhe hormoneve. Të mos kemi frikë nga yndyrat! Më tepër të përqëndrohemi që në vend të yndyrave pa lidhje dyfishe të konsumojmë yndyrat e shëndetshme me lidhje dyfishe të tipit **omega-3 dhe omega-9!**

Këto yndyra organizmi ynë nuk i krijojnë dot, prandaj marrja e tyre është po aq e nevojshme sa edhe e vitaminave. Në mungesën e tyre mund të krijohen probleme në rritje, përqëndrim, mësim, funksionet nervore dhe probleme lëkure. Por të shmangim konsumimin e „yndyrave të këqija” (pa lidhe dyfishe



dhe trans) së bashku me karbohidratet që përthithen shpejt!

Proteinat janë elementët ndërtues të organizmit tonë. Sistemi imunitar, flokët, nervat, muskujt, të gjitha këto ndërtohen nga aminoacide, por organizmi ynë nga këto ndërton edhe hormone, enzima, lëndë transmetuese dhe transportuese. Nga 22 aminoacide 8 janë esenciale, të cilat organizmi nuk mund t'i krijoj dot, prandaj këto duhen siguruar nëpërmjet ushqimeve. Proteinat e ushqimit organizmi fillimisht i shpërbën në aminoacide, pastaj ndërton prej tyre proteinat e trupit. Energjinë e nevojshme për këtë e mbulon nga djegia e yndryave.

Shumë dieta kanë mungesë proteinash, dhe në këtë rast organizmi fillon të shpërbëjë proteinat e veta të muskujve dhe nervave. Rrëzohen flokët, thyen thonjtë, shtohet nervozizmi dhe mund të krijohen probleme në funksionin nervor. Nga 100 gr proteina kafshësh krijohen 70 gr proteina trupi, kurse nga 100 gr proteina bimësh 30 gr proteina trupi, prandaj më të favorshmet janë koncentratet e proteinave që përmbajnë edhe proteina kafshësh (proteina qumshti dhe hirre) edhe bimësh (psh. soja), duke rritur me këtë vlerën biologjike dhe duke optimalizuar cilësinë.

Karbohidratet gjithashtu janë shumë të rëndësishme, por nuk rekomandojmë sheqernat e thjeshta që përthithen shpejt, por "sheqernat e mira" që gjenden në perime, fruta dhe bërthamat e paqëruara! Këto nuk e dëmtojnë veshkën, mëlçinë, kockat, i bëjnë mirë aparatit të zorrëve dhe nuk e ngarkojnë stomakun. Përmirësojnë nivelin e kolesterolinës dhe yndryave në gjak, normalizojnë metabolizmin, dhe meqë

përthithja e ngadaltë e karbohidrateve normalizon nivelin e sheqerit në gjak, ulin edhe ndjenjën e urisë! Karbohidratet që përthithen shpejt shkaktojnë një rritje të menjëhershme të sheqerit në gjak e cila e stimulon pankreasin të prodhojë shumë insulin. Qelizat pas një farë kohe për fat të keq bëhet të pandjeshme ndaj insulinës dhe për shkak të lëkundjes së nivelit të sheqerit në gjak rritet edhe ndjenja e urisë, e cila sjell marrjen e kalorive të tepërta. Përpunimi jo i duhur i karbohidrateve në organizëm shkakton probleme serioze në metabolizëm, ndoshta edhe sëmundje sheqeri, prandaj është mirë t'i kushtojmë vëmendje kësaj. Shpeshherë trashja e mesit tregon se organizmi nuk i përpunon në mënyrën e duhur sheqernat!

2. Plotësuesit ushqimor

E konsideroj shumë të rëndësishëm konsumimin e **lëngjeve në sasinë dhe cilësinë e duhur** kurdo, por gjatë dietës kjo kërkon veçanërisht një vëmendje të madhe! Pasi pa lëngje s'ka djegie të yndryave dhe detoksikim! Rekomandoj çajet mjekësore dhe ujin mineral me përmbajtje të ulët të natriumit, nga i cili mund të pimë edhe 3-4 litra në ditë. Sasia minimale e lëngjeve gjatë dietës është 2,5-3!

Marrja e **vitaminës C** në sasi të mëdha është tepër e rëndësishme! Është një djegëse yndyrash, antioksidant dhe përforcuese imuniteti e shkëlqyer. tendos lëkurën, ngurtëson dhe forcon indin lidhës.

Kalciumi djeg yndyrat dhe aktivon enzimatet të tretës. **Magnezi** është



një dobësues me vlerë. Luan rol në funksionimin e duhur dhe të ekuilibruar të nervave dhe muskujve, merr pjesë në furnizimin e qelizave me oksigjen dhe nëpërmjet kësaj në djegien e yndryave. **Jodi** normalizon metabolizmin, në mungesën e tij ngadalësohen funksionet fiziologjike.

Vëmendje të madhe duhet t'i kushtojmë marrjes së kromit, kryesisht në formën e **krom-pikolinatit**. Ky mikroelement me rëndësi jetike luan rol në përpunimin e sheqernave, në metabolizmin e proteinave dhe yndryave. Tek të moshuarit pengon humbjen e kalciumit nga kockat, shton futjen e proteinave në trup. Rrit efektin e insulinës, prandaj për sigurimin e nivelit të duhur të sheqerit në gjak mjafton më pak insulin, kështu nuk harxhohen para kohe qelizat që prodhojnë insulin. Normalizon nivelin e sheqerit në gjak, nëpërmjet kësaj ul ndjenjën e urisë dhe oreksin, dhe pengon plakjen.

Duhet të kujdesemi edhe për marrjen e sasisë së duhur të **fibrave**. Duke hyrë në aparatit të zorrëve lidhin ujë, fryhen, krijojnë ndjenjë ngopje dhe ulin oreksin. Detoksikojnë, thithin toxinat me origjinë bakteriale dhe ulin mundësinë e infeksionit bakterial. Përshejtojnë sekretimin e lëngut të tëmthit, ulin nivelin e kolesterolinës dhe stimulojnë funksionin e zorrëve. Plotësuesi ushqimor që përmban **baktere probiotike**, të cilat sigurojnë florën



normale të aparatit të zorrëve, është i domosdoshëm gjatë dietës. Këto baktere rregullojnë florën normale të zorrëve, forcojnë imunitetin dhe ndihmojnë përthithjen e duhur të lëndëve ushqyese. Produktit të mos i nevojitet ambienti i ftohtë, kështu mund ta marrim kudo me vete, dhe acidi i stomakut të mos i dëmtojë bakteret e dobishme.

3. Gjymnastika

Sporti është një djegës i shkëlqyer yndyrash. Rrit qëndrueshmërinë, forcën e muskujve, përmirëson qarkullimin e gjakut, ul stresin, përmirëson gjendjen shpirtërore, ul depresionin. Përpunimi i glukozës në nivel qelizor bëhet më efektiv dhe nevojitet më pak insulin. Të heq vëmendjen nga frigriferi.

Gjymnastika duhet planifikuar sipas personit, duke marrë parasysh peshën, rreziqet ortopedike, gjendjen paraprake fizike, sëmundjet e mundshme, problemet e kyçeve dhe mundësitë.

Dita 3-10: periudha e fillimit të dobësimit

Mëngjes: 1 dl Xhel Aloe + pije Ultra-Lite + 2 caps. Garcinia
 Ora dhjetë: 2 tbl. Pollen + 2 tbl. C-vit
 Dreke: pije Ultra-Lite + 2 tbl. Pollen + 2 caps. Garcinia
 Darkë: 1 dl Xhel Aloe + 2 tbl. Fields + 2 caps. Garcinia + 600 kcal ushqim + plotësuesit ushqimor dhe lëngjet e deritanishme.

Lëvizja e ngadalhtë dhe e njëtrajtshme, shëtitja, marshimi, ngjitja e shkallëve, hedhja nga trampolini, callanetics apo ngritja e peshave janë të gjitha të efektshme, thelbi është që **pulsi të jetë nën 130**, sepse kështu ndodh djegja e yndyrave!

Me dijeninë e këtyre të shohim se çfarë rekomandojmë!

Të përcaktojmë indeksin e peshës së trupit tonë me ndihmën e formulës së mëposhtme:

Indeksi i peshës së trupit: Pesha (kg):
 gjatësia (m) x Gjatësia (m)
 19-25 ideale
 25-30 mbipeshë e lehtë
 mbi 31 mbipeshë e konsiderueshme

Pas llogaritjes së indeksit të peshës së trupit të vendosim peshën që duhet të arrijmë dhe të bëjmë përveç matjes së peshës edhe disa matje të tjera bazë, pasi vetëm duke parë rezultatet e matjeve mund të shohim dobësimin jo vetëm në kg, por edhe në centimetra. Gjerësia e gjoksit, e mesit, e vitheve, perimetri i kofshës dhe krahut, apo matja e përqindjes së dhjemit në trup na informon në mënyrë të shkëlqyer. Matje bëjmë pas dy ditëve të para, pas ditës së 9-të, dhe pastaj çdo javë. Ta fillojmë!

Nëse punën dhe kohën e keni të tillë, mund ta ndërtoni pa problem drekën me darkën, ushqimimin përshtatni me punën tuaj dhe planifikojeni këtë me këshilltarin tuaj! Pas 9 ditësh bëjmë matje! Shikojmë se sa arritëm të biem nga pesha dhe në bazë të të dhënave të tabelës shikojmë se sa është rezistenca e metabolizmit të organizmit tuaj, pasi për të patur sukses mëtej duhet të ushqehemi në përputhje me këtë.

Dita 1-2: pastrim, detoksikim

Mëngjes: 1 dl Xhel Aloe + 2 caps. Garcinia
 Ora dhjetë: 2 tbl. Pollen
 Dreke: 1 dl Xhel Aloe + 2 caps. Garcinia + 2 tbl. Pollen
 Darkë: 1 dl Xhel Aloe + 2 caps. Garcinia + 2 tbl. Pollen
 Në mbrëmje: 1 dl Xhel Aloe + 2 copë Fields of Greens + 2 l çaj dhe 1 l lëng tjetër (ujë) është i rëndësishëm!!!
 + 2-4 tabl. Vitamin C, Nature Min, Nature's 18 kurdo gjatë ditës

Rezistenca e madhe e metabolizmit mund të ketë disa shkaqe.

- "Kura" të pasuksesshme, dieta të njëanëshme, dieta "yoyo" prej vitesh të tëra
- Niveli i lartë i insulinës dhe rezistenca ndaj insulinës e cila shpeshherë shoqërohet me nivel të lartë sheqeri në gjak
- Marrja e ilaçeve, hormoneve (kontraceptivë, estrogjene, ilaçe kundër depresionit, antiinflamativ, diuretik, beta-blokuues)
- Funksionimi i pamjaftueshëm i gjendrës tiroide
- Dominimi i myqeve (candida) në organizëm, në aparatit të zorrëve.

Nëse ju dobësoheni me vështirësi, e keni të madhe rezistencën



e metabolizmit, me siguri ekziston ndonjë nga shkaqet e sipërpërmendura, edhe nëse s'keni dijeni për të. Iu rekomandoj ta vazhdoni dietën, por në ushqimimin me 600 kcal duhet t'u jepni përparësi ushqimeve me pak karbohidrate, dhe duke e rritur gradualisht sasinë e karbohidrateve të gjeni sasinë me të cilën dobësoheni apo e ruani peshën tuaj! Si ndihmë të keni disa ushqime

DJATHRA: mozaletë, i bardhë, çdo gjë që ka përmbajtje të ulët karbohidratesh! (10-15 dkg)
SALLATË, PERIME: sallatë jeshile, qepë e njomë, kërpudha, rrepa, trangull, majdanoz, ullinj, (8-10 kokrra) lakra kineze, shpargull, lakër, brokol, syth bambusi, lule lakër, selino, pras, domate, spinaq, lëpjetë, karrotë!

kaloni në programin 30 ditor që pas 9 ditëve të para, duke parë çdo javë rezultatet e matjeve në rrugën drejt peshës së dëshiruar të trupit!

Pas studimit të programit nxorrem konklusionin se nëpërmjet marrjes së ushqimeve **të shëndetshme**, të tolerueshme dhe cilësore iu ofrojmë një dietë **të sigurt**.

Duhet t'i përgjigjemi edhe pyetjes së tretë! Nëse e bëtë deri në fund këtë program, në ushqimimin tuaj krijuat zakone të reja, mësuar se çfarë është shëndeti, sa mund të hani pa u shëndoshur, dhe që të mos lejoni të shtoni më shumë se 2-3 kg, pra **të mbani peshën!** Nëse e lëshoni pak veten, përsëriteni programin 9 ditor dhe kushtojini vëmendje ushqimit tuaj, që mos ta filloni dietën kur të keni 10 kg mbipeshë! Bëni gjimnastikë rregullisht sepse kështu e ruani peshën dhe shëndetin tuaj.

Iu uroj suksese të shumta!

REZISTENCA E METABOLIZMIT			
MESHKUJT	Pesha e humbur gjatë 9 ditëve		
Pesha e humbur	Rezistencë e madhe	Rezistencë e zakonshme	Rezistencë e vogël
Më pak se 10 kg	2 kg	3 kg	4 kg
Ndërmjet 10-25 kg	3 kg	4,5 kg	6 kg
Më shumë se 25 kg	4 kg	6 kg	8 kg

REZISTENCA E METABOLIZMIT			
FEMRAT	Pesha e humbur gjatë 9 ditëve		
Pesha e humbur	Rezistencë e madhe	Rezistencë e zakonshme	Rezistencë e vogël
Më pak se 10 kg	1-1.5 kg	2 kg	3 kg
Ndërmjet 10-25 kg	1.5-2 kg	3 kg	4.5 kg
Më shumë se 25 kg	2-3 kg	4 kg	6 kg

të cilat mund t'i hani dhe disa të cilat duhet t'i shmangni.

ATO QË MUND TË KONSUMOHEN!

MISHRA: çdo lloj mishi, derri, lope, deleje, të egër...

PESHK: çdo lloj, më të mirët janë peshqit e ujrave të ftohta, ton, salmon, sardele, harengë...

SHPENDË: çdo lloj të skuqur në vaj ulliri, të zjerë, të pjekur...

FRUTA DETI: karkaleca, sepje, midhje...

VEZË: të skuqur, të rrahur, të butë, të fortë...

ATO QË JO!

Nuk mund të hani bukë, fruta, drithra, perime që përmbajnë nisështe, nga prodhimet e qumshtit vetëm djath dhe salcë kosi (1dl!). S'ka oriz, patate, çokollatë, fara të yndryshme, fruta me lëvore!

Nëse në 9 ditët e ardhshme jemi të kënaqur, gradualisht hyjmë në programin 30 ditor, dhe nëse është e nevojshme edhe këtu mund ta ulim raportin e karbohidrateve.

Nëse rezistenca e metabolizmit tuaj është mesatare ose e vogël, mund të

Mëngjes: Ultra-Lite + 2 caps.
Garcinia + 2 tbl. Pollen + frut
Ora dhjetë: 1 dl Xhel Aloe + bukë e thekur me gjalp
Drekë: Ultra-Lite + 2 caps.
Garcinia + 2 tbl. Pollen + perime ose sallatë me salcë të lehtë
Uzsona : 1 dl Xhel Aloe + fruta
Vacsora: 2 caps. Garcinia + 2 tbl. Pollen ose 2 tbl. Fields of Greens + Probiotic
+ 400 kcal ushqim + plotësuesit ushqimor dhe lëngjet e deritanishme.

Shtypi

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari.

Redaktoi: FLP Magyarorszag Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Redaktori kryesor: Dr. Miliesz Sándor

Redaktor: Kismárton Valéria, Veress Angéla, Rókás Sándor

Përgatitja për shtypje: Tipofill 2002 kft.

Grafika: Teszár Richárd, Buzássy Gábor

Shtypi: Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 kopje

Për përmbajtjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

Përkthyes, redaktues: shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko

– serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana



Më 25 maj 2007 në Szirak

Sonya Health &



FOREVER

bëmë hapjen solemne të

Beauty Center



RESORTS

*I mirëpresim të
gjithë punonjësit
tanë që duan të
mësojnë dhe pushojnë*

Sonya[®]
Color Collection

*në Qendrën
e Mësimit dhe
Shërbimit Sonya.*

1183 Budapest, rr. Nefelejcs 9-11
Tel.: +36-1-291-8995/151
+36-20-416-6329

1067 Budapest, rr. Szondi 34
Tel.: +36-1-269-5370/151
+36-20-457-1155